



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

Drejtuar: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “LIQENI VII” sha & “BALILI KONSTRUKSION” shpk

Adresa: Rruga “Dituria”, Shkozet, Durrës.

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur”, “Rikualifikim urban i bllokut që kufizohet bulevardi Bajram Curri-bulevardi Petro N. Luarasi- Rruga Taulantia- Rruga Ali Demi, Faza II-të”.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-59761-02-21-2023.**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Rikualifikim urban i bllokut që kufizohet bulevardi Bajram Curri-bulevardi Petro N. Luarasi- Rruga Taulantia- Rruga Ali Demi, Faza II-të”.**

Fondi limit: **270,292,998.96** (dyqind e shtatëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 18 (tetëmbëdhjetë) muaj kalendarik.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Nr.19, datë 27 Shkurt 2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “CURRI” shpk

NUIS J67902718S

Vlera e ofertës: 149,026,250.40 (njëqind e dyzetë e nëntë milion e njëzetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë pikë dyzetë) lekë pa TVSH

2. Bashkimi i operatorëve ekonomik “EURO-ALB” shpk & “LLAZO” shpk & “VIANTE Konstruksion”

NUIS K66613407H & NUIS K24218401K & NUIS K47103804L

Vlera e ofertës: 174,121,668 (njëqind e shtatëdhjetë e katër milion e njëqind e njëzetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH

3. Operatori ekonomik “KTHELLA” shpk

NUIS J69303023D

Vlera e ofertës: 183,055,115 (njëqind e tetëdhjetë e tre milion e pesëdhjetë e pes mijë e njëqind e peëmbëdhjetë) lekë pa TVSH

4. Operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” shpk NUIS K61625001I

Vlera e ofertës: 185,762,140.50 (njëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind e dyzetë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH

5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “GLAVENICA” shpk & “B-93” shpk
NUIS K17710805A & NUIS J62903508R

Vlera e ofertës: 186,911,176 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “INA” shpk & “2 N” shpk
NUIS J61814009W & NUIS L31615017L

Vlera e ofertës: 196,126,796.10 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e njëzetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë dhjetë) lekë pa TVSH

7. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “INERTI” shpk & “ARB & TRANS-2010” shpk
NUIS J66926804L & NUIS L02325001T

Vlera e ofertës: 202,514,560 (dyqind e dy milion e pesëqind e katërbëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH

8. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “LIQENI VII” sha & “BALILI KONSTRUKSION” shpk
NUIS K01730502W & NUIS K17016202S

Vlera e ofertës: 206,866,815.50 (dyqind e gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH

9. Operatori ekonomik “BAMI” shpk NUIS J94416206R

Vlera e ofertës: 212,119,521.40 (dyqind e dymbëdhjetë milion e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëzetë e një pikë dyzetë) lekë pa TVSH.

10. Operatori ekonomik “PE – VLA - KU” shpk NUIS K61716013M

Vlera e ofertës: 248,558,756.20 (dyqind e dyzetë e tetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë njëzetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “CURRI” shpk NUIS J67902718S

Operatori ekonomik "Curri" shpk nuk përmbush kërkesës sipas kriterëve të përgjithshme të Dokumenteve Standarte të Tenderit: "Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës" pasi nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur rezulton se është mbështetur në kapacitetet e operatorit ekonomik "Xhengo" shpk per dy punonjës hidraulik por mungon formulari vetepërmbledhës I deklaramit per mbeshtetesin.

Operatori "Curri" shpk nuk plotëson pikën 8 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të tenderit: "*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve te cilet duhet te figurojne ne listpagesat e shoqërisë.....*" pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit ka deklaruar thjesht punonjës manovratorë dhe jo punonjësit e kërkuar eskavatoriste, automakinist dhe buldozeriste.

Operatori ekonomik "Curri" shpk nuk plotëson pikën 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: "*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht*"... pasi nga 3 mejeje eskavator të kërkuar ka deklaruar vetëm 2.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomik "EURO-ALB" shpk & "LLAZO" shpk & "VIANTE Konstruksion"

NUIS K66613407H & NUIS K24218401K & NUIS K47103804L

Operatori ekonomik "Euro-Alb" shpk nuk plotëson pikën 3 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: "*Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt*"..... Nga verifikimi dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit rezulton se Operatori ekonomik "Euro-Alb" shpk ka paraqitur deklaratën per Drejtuesin Teknik te punimeve ne objekt me inicialet B.M me profesion **Inxhinier Gjeodet**, cka bie ne kundërshtim me Udhezimin Nr.2, date 13.05.2005, Kreu I, pika 2.1, paragrafi 2, ku citohet se: "*Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi*".

Operatori ekonomik "Llazo" shpk nuk plotëson pikën 3 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: "*Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt*"..... Nga verifikimi dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit rezulton se Operatori ekonomik "Llazo" shpk ka paraqitur deklaratën per Drejtuesin Teknik te punimeve ne objekt me inicialet A.LL por nga verifikimi i licensës së zbatimit të punimeve rezulton vetëm si drejtues ligjor dhe jo drejtues teknik.

3. Operatori ekonomik "KTHELLA" shpk

NUIS J69303023D

Operatori ekonomik "Kthella" shpk në deklaratën për drejtuesin teknik nuk ka deklaruar që drejtuesi teknik do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt cka bi në kundërshtim me kërkesën e pikës 3 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: "*Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se*

nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme.....”

Operatori ekonomik “Kthella” shpk nuk përmbush kërkesës sipas kritereve të përgjithshme të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës” pasi nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur rezulton se është mbështetur në kapacitetet e operatorit ekonomik “Ndërtuesi 2014” I cili në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nuk ka deklaruar shlyerjen e taksave vendore cka bie në kundërshtim edhe me pikën 3 të kapacitetit ekonomik dhe financiar: “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 dhe per vitin 2022 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB”.

Operatori ekonomik “Kthella” shpk nuk plotëson pikën 6 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “*Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1(nje) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4, shoqeruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin”* pasi eksperti zjarrfikës I deklaruar rezulton I anagazhuar në kontratë e lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë me objekt: “Rikualifikim i bllokut që kufizohet nga rrugët “Liman Kaba”, “Prokop Mima”, “Robert Shvarc dhe “Skënder Luarasi” e cila i vazhdon efektet ligjore-teknike dhe fiannaciare.

Operatori ekonomik “Kthella” shpk nuk plotëson pikën 7, gërma “a” të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “*1 (një) punonjes i pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqeruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”)*” pasi eksperti për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave i deklaruar rezulton i anagazhuar në kontratë e lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë me objekt: “Rikualifikim i bllokut që kufizohet nga rrugët “Liman Kaba”, “Prokop Mima”, “Robert Shvarc dhe “Skënder Luarasi” e cila i vazhdon efektet ligjore-teknike dhe fiannaciare.

4. Operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” shpk

NUIS K6162500II

Operatori ekonomik “Ed Konstruksion” shpk nuk përmbush kërkesës sipas kritereve të përgjithshme të Dokumentev Standarte të Tenderit: *“Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim”* pasi nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur rezulton se është mbështetur në kapacitetet e operatorit ekonomik “COLOMBO” shpk I cili nuk ka paraqitur një angazhim me shkrim për ofrimin e kapaciteteve mbështetese cka bie në kundërshtim edhe me Nenin 84, pika 3 të Ligjit 162/2021.

Operatori ekonomik “Ed Konstruksion” shpk nuk përmbush kërkesës sipas kritereve të përgjithshme të Dokumentev Standarte të Tenderit: *“Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”* pasi nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur rezulton se është mbështetur në kapacitetet e operatorit ekonomik “COLOMBO” I cili në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nuk ka deklaruar shlyerjen e taksave vendore cka bie në kundërshtim edhe me pikën 3 të kapacitetit ekonomik dhe financiar: *“Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 dhe për vitin 2022 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB”*.

Operatori ekonomik “Ed Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht”...*” pasi është deklaruar i njejtin mjet me targa VL7985C, si Eskavator me Goma dhe Fadrome me Goma, e për pasojë njeri nga mjetet e kerkuara nuk plotësohet.

5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “GLAVENICA” shpk & “B-93” shpk

NUIS K17710805A & NUIS J62903508R

Bashkimi i operatorëve ekonomik Glavenica & B-93 shpk, ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, 3 (tre) eskavator me goma por pas verifikimit vetëm një nga eskavatorët me goma të deklaruar është me dokumentacion të rregullt. Për dy eskavatorët me goma nuk janë deklaruar targat, nr. e shasisë, nr. e lejes së qarkullimit cka bie në kundërshtim me kërkesat e pikës 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht”...*”

Operatori ekonomik “B-93” shpk në deklaratën për drejtuesin teknik nuk ka deklaruar që drejtuesi teknik do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt cka bie në kundërshtim me kërkesën e pikës 3 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e*

fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme.....”.

Bashkimi i operatorëve ekonomik “Glavenica” shpk & “B-93”shpk nuk plotëson pikën 8.2, gërma” c” të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit eskavatoriste, automakinist dhe buldozeriste, emer/mbiemer, profil i punes, numri dhe daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale”* pasi nuk është deklaruar afatin e vlefshmerise se deshmise se aftësisë profesionale për punonjësit Manovrator, Automakinist dhe Budozeriste.

6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “INA” shpk & “2 N” shpk

NUIS J61814009W &NUIS L31615017L

Operatori ekonomik “INA” shpk në deklaratën për drejtuesin teknik nuk ka deklaruar që drejtuesi teknik do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen *punimet në objekt* cka bi në kundërshtim me kërkesen e pikës 3 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme.....”.*

Bashkimi i operatorëve ekonomik “INA”shpk “2N”shpk nuk plotëson pikën 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht”...*” pasi pas verifikimit vetem nje nga eskavatoret me goma te deklaruar eshte me dokumentacion te rregullt.

Bashkimi i operatorëve ekonomik “INA”shpk “2N”shpk nuk plotëson pikën 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht”...*” pasi nga 2 mjete fadromë me goma të kërkuar ka deklaruar vetëm 1.

7. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “INERTI” shpk & “ARB & TRANS-2010” shpk

NUIS J66926804L &NUIS L02325001T

Bashkimi i operatorëve ekonomik “Inerti”shpk “Arb Trans 2010”shpk nuk plotëson pikën 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht”...*” pasi nga 3 mjete eskavator me goma te krkuar vetem 1 eshte me dokumentacion te rregullt, pasi mjeti eskavator me targa AEMT76 nuk eshte dekaruar nr I shasisë dhe për mjetin me targë ABMT 58 nuk është dekaruar nr I lejes së qarkullimit.

Bashkimi i operatorëve ekonomik “Inerti”shpk “Arb Trans 2010”shpk nuk plotëson pikën 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht”...* pasi nga 3 mjete eskavator me goma te krkuar vetem 1 eshte me dokumentacion te rregullt, pasi nga 3 fadroma të kërkuara vetëm 1 është me dokumentacion të rregullt pasi për fadromën me targë AAMT20 nuk është deklaruar nr i shasisë.

Bashkimi i operatorëve ekonomik “Inerti”shpk “Arb Trans 2010”shpk nuk plotëson pikën 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht”...* pasi nga 3 mjete eskavator me goma te krkuar vetem 1 eshte me dokumentacion te rregullt, pasi per mjetet e marra me qera rrul me vibrim dhe rrul me kompresor nuk është deklaruar afati I kontratës së qerasë.

Bashkimi i operatorëve ekonomik “Inerti”shpk “Arb Trans 2010”shpk nuk plotëson pikën 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht”...* pasi nga 3 mjete eskavator me goma te krkuar vetem 1 eshte me dokumentacion te rregullt, pasi per mjetin e marrë me qera autobitumartice nuk është deklaruar afati I kontratës së qerasë.

Bashkimi i operatorëve ekonomik “Inerti”shpk “Arb Trans 2010”shpk në deklaratën për drejtuesin teknik nuk ka deklaruar që drejtuesi teknik do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen *punimet në objekt* cka bi në kundërshtim me kërkesen e pikës 3 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme.....”.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatorëve ekonomikë **“LIQENI VII”** sha & **“BALILI KONSTRUKSION”** shpk, me adresë: Rruga “Dituria”, Shkozet, Durrës, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 206,866,815.50 (dyqind e gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë) lekë pa tvsh është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.